




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.52/2024
Datë:22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, të Kushtetutës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 53, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 57, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohen në tërësi vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.197/2023 i datës 18 maj 2023 dhe KGJK.nr.238/2023 i datës 12 qershor 2023, lidhur me transferimin e përhershëm të bashkëpunëtorit profesional Burim Geci, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- II. Z. Burim Geci, do të vazhdoj punën si bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.197/2023 të datës 18.05.2023 ka transferuar në mënyrë të përhershme bashkëpunëtorin profesional Burim Geci, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë në Gjykata Themelore në Prishtinë nga data 1 korrik 2023. Me vendimin KGJK.nr.238/2023 i datës 12.06.2023, të njëjtit i është vazhduar qëndrimi në Gjykatën Themelore Mitrovicë deri me datë 1 maj 2024.

Z. Geci me datë 11 janar 2024, kishte tërhequr kërkesën e tij për transferim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar që të vazhdoj punën si bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Themelore në Mitrovicë edhe pas datës 01 maj 2024, për shkak të ngarkesës me lëndë në këtë gjykatë si dhe stafit të reduktuar, me ç'rast kjo kërkesë ishte mbështetur edhe nga U.D. Kryetari i Gjykatës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës së z. Geci, duke marr parasysh se vendimet lidhur me transferimin e tij të përhershëm në Gjykatën Themelore në

Prishtinë, akoma nuk kishin filluar të zbatoheshin, e rrjedhimisht nuk kishin prodhuar efekte apo pasoja juridike, konform legjislacionit në fuqi, vendosi t'i shfuqizoj të njëjtat.

Nga sa u tha më lart, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Vendimi i dërgohet:

- Bashkëpunëtorit profesional, z. Burim Geci;
- U.D. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë;
- Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGJK;
- Sekretariatit të KGJK-së dhe
- Arkivit të SKGJK.